

Feja dhe Shoqëria në Ballkanin Perëndimor

Tiranë, 11 qershor 2019

## FEJA DHE SHOQËRIA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë,

Anastas Janullatos

Profesor Emeritus i Universitetit Kapodistrian të Athinës

Anëtar Nderi i Akademisë së Athinës

1. *Realiteti i Përgjithshëm Fetar*. Feja, që në shekujt e parë të krishterë, ka luajtur një rol fundamental në transformimin e kulturës, vetëndërgjegjësimin dhe të identitetit kombëtar të popujve të Ballkanit. Megjithatë, në pjesën më të madhe të këtyre vendeve, në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, dominuan regjime autoritare që imponuan edukimin, mentalitetin dhe strukturën sociale ateiste.

Por, pavarësisht nga ky fakt, kërkimi për gjetjen e kuptimit të ekzistencës njerëzore mbetet stimul kryesor që udhëheq miliona njerëz drejt një komuniteti fetar. Asnjë fuqi nuk mund ta ndalojë një kërkim të tillë, sepse identifikohet me vetë ekzistencën njerëzore. Pyetja kryesore që shtrohet, është se si do të bashkëveprojnë mes tyre pikëpamjet e ndryshme fetare dhe si ato do të kontribuojnë për një bashkëjetesë krijuese dhe që mos të shndërrohen në faktorë konfliktesh.

Mungesa e tolerancës midis komuniteteve fetare që bashkekzistojnë mund të lindë si nga rrënjët e një tipi fetar, si për shembull fundamentalizmi ekstrem, ashtu edhe nga rrënjë jofetare, siç janë faktorët politikë, nacionalistë, psikologjikë apo egoistë. Të gjitha këto rrënjë kanë qenë të fuqishme në të shkuarën dhe vazhdojnë të jenë të tilla në Ballkanin Perëndimor.

Nga ana tjetër, bashkëjetesa paqësore e komuniteteve fetare mund të burojë edhe nga dy pikënisje të kundërta: si nga indiferenca ndaj përvojës fetare, ashtu edhe nga një përvojë e ndërgjegjshme e esencës më të thellë të fesë, siç na paraqitet në jetën e shumë personaliteteve të shquara të të gjitha feve.

Në realitetin e sotëm të Ballkanit, themeli për çdo vendim të përbashkët për bashkëjetesë paqësore midis komuniteteve fetare, si edhe midis grupeve jofetare, mund të mbështetet në respektimin e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara të, të Drejtave të Njeriut si dhe të Lirisë së Ndërgjegjes. Në ditët tona, shoqëritë e krishtera dhe ato islame, pak a shumë, i aprovojnë këtë deklaratë.

2. *Situata në Shqipëri.* Jeta fetare e çdo vendi të Ballkanit Perëndimor është e larmishme. Në pjesën më të madhe të shteteve të tij, mbizotëron një fe e cila është lidhur me identitetin, kulturën, rezistencën dhe shpresat e popullit të vet. Për sa i takon eksperiencës së veçantë fetare që kemi në Shqipëri, myslimanët (sunitë dhe bektashinj) dhe të krishterët (orthodhoksë, katolikë dhe protestantë) jetojnë së bashku në një shoqëri demokratike shekullare, e cila nuk ka asnjë lidhje të veçantë, pozitive apo negative, me asnjë nga komunitetet fetare. Kolapsi i komunizmit shtoi grupime të tjera informale në skenën e sotme fetare- “grupimet afetare”. Grupime të tilla mbeten të papërcaktuara dhe nuk kanë një strukturë të tyren, por ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme në shoqërinë e sotme.

Në periudhën e tranzicionit të dekadave të fundit, në shoqërinë shqiptare është shfaqur një krizë e përgjithshme në sistemin e saj të vlerave, që ka sjellë edhe një krizë besimi ndaj formave të ndryshme të autoritetit, si edhe një pasiguri se çfarë është autentike dhe çfarë jo. Ndërsa në të shkuarën mbizotëronin sloganet e kolektivizimit utopist, sot rinia bombardohet nga mesazhet e një kapitalizmi egocentrik sekular. Një stepje e veçantë mbizotëron kudo, që përkthehet në apati dhe në indiferencë, kurse në raste të tjera, si dëshirë për t’u larguar nga gjithçka. Brenda këtij vakumi shpirtëror, komunitetet fetare përpiqen të kultivojnë besimin te Perëndia dhe të çelin horizonte të reja shpirtërore, që do të forcojnë idetë shpirtërore të vendit dhe rregullin e tij të brendshëm, si dhe do të mbështesin durimin dhe krijimtarinë e popullit. Por, sigurisht, diçka e tillë mund të arrihet vetëm në kushtet e një bashkëjetese paqësore me njëri-tjetrin.

3. *Duke menduar sërish për kuptimin e nacionalitetit.* Asnjë komb nuk ka të drejtë të monopolizojë Perëndinë dhe t’i konsiderojë popujt e tjerë si të dorës së dytë. Apostull Pavli e thekson fare qartë se Perëndia “bëri prej një gjaku çdo komb njerëzish, që të banojnë në të gjithë faqen e dheut” (Veprat 17:26). Të gjitha kombet bëjnë pjesë në të njëjtin njerëzim që u krijua nga i njëjti Perëndi. Në periudhën e re të globalizimit, çdo komb ftohet të përballet me problemin e madh të ruajtjes së identitetit të tij. Pretendimi i

të qenurit unik nuk mund të përdoret si pengesë në marrëdhëniet tona me fqinjët tanë, si mur që na pengon të respektojmë të vërtetën dhe drejtësinë. Për shumë shekuj, popujt e Ballkanit kanë jetuar së bashku brenda perandorive të fuqishme- në ato romake, bizantine dhe otomane- duke krijuar një kulturë të veçantë ballkanike me anë të ndërveprimit midis tyre. Kjo cilësi e tyre vazhdon të jetë e rëndësishme edhe në formën e re të “perandorisë” që po vjen- të Bashkimit Evropian.

Për ne ka ardhur koha të korrigjojmë imazhin, shpesh të shtrembëruar, të gabuar për “tjetrin, që është formuar në ndërgjegjen e popujve të Ballkanit” prej stereotipeve ksenofobike me anë të metodave të ndryshme nga grupime të shumëllojta nacionaliste. Ne duhet të zbulojmë dhe të njohim anët pozitive të fqinjëve tanë dhe të mësojmë të bashkëpunojmë. Zhvillimi dhe prosperiteti i një fqinji mund të ndihmojë edhe progresin tonë. “Tjetri” nuk duhet parë si një kërcënim, por mund të bëhet një bekim në rrethanat e duhura.

\*

Si përfundim, që vizioni për një bashkëjetesë paqësore midis popujve të Ballkanit të kthehet në realitet, nevojiten nisma të reja, me mendim krijues dhe me një perspektivë më të gjerë. Të gjitha komunitetet fetare duhet të kërkojnë parime të shëndetshme antropologjike që burojnë nga pasuria e doktrinës dhe nga cilësitë më të mira të traditës së tyre, duke theksuar respektin e sinqertë për çdo qenie njerëzore. Gjithashtu, duhet të përpiqemi edhe për zhvillimin dhe mbizotërimin e këtyre parimeve nëpërmjet etikës së udhëheqjes fetare, si dhe edukimit të anëtarëve të tyre. Duhet theksuar në mënyrë të veçantë fakti, se çdo lloj lufte ose dhune në emër të fesë është në të vërtetë një cenim ndaj vetë fesë.

Kemi bindjen e thellë se, në këtë çast historik, i vetmi antidot për dhunën e mbjellë në rajonin tonë janë iniciativat e dashurisë së sinqertë, të ndërmarra me guxim dhe këmbëngulje, sepse dhuna është kërcënim më i madh për të dhe në periudhë afatgjatë ka qenë po aq e rrezikshme sa dhe radioaktiviteti.

Propozim ynë konstant është ky: Me anë të kontributit aktiv të të gjitha komuniteteve fetare dhe të çdo personi vullnetmirë, le të ecim përpara drejt një komuniteti më të gjerë paqeje dhe solidariteti, që siguron drejtësinë dhe dinjitetin njerëzor për çdo person, për çdo popull, për çdo minoritet dhe që përfundimisht na çon drejt një kulture më të thellë njerëzore.